

- o Forma e njoftimit publik ishin, në faqen e Këshillit Bashkiak Kuçovë në facebook dhe në faqen Web www.bashkiakucove.gov.al në rubrikën të dedikuar vetëm Këshillit Bashkiak.
- o Datat e takimeve të hapura për këshillimin publik ishin 18.05.2021, Bashkia Kuçovë (22.10.2021), Njësitë Administrative Kozare dhe Perondi (26.10.2021), Bashkia Kuçovë (28.10.2021), Njësia Administrative Lumas (09.11.2021) Town Hall Bashkia Kuçovë (09.11.2021).
- o Grupet e këshilluara në takimet për konsultim publik ishin, grupet e biznesit, shoqëria civile, të treja njësitë administrative (Kozare, Perondi, Lumas) dhe Bashkia e vjetër.

Vendimet, në lidhje me tematikën e vendimeve, 48 ishin për çështjet financiare, 4 ishin për çështje infrastrukture, 7 për çështje emergjenca civile, 11 ishin për çështjet urbane dhe pronat dhe 16 ishin çështje të ndryhme.

Dëgjesat publike, janë realizuar në të gjitha njësitë Administrative (Kozare, Perondi, Lumas) dhe në Bashkinë e vjetër të Qytetit Kuçovë. Në këto dëgjesa është vërejtur prezencë si të meshkujve dhe femrave. Gjatë vitit 2021 morën pjesë 31 persona në konsultimet publike, 10 ishin femra dhe 21 meshkuj.

Mbledhjet e Këshillit, gjatë vitit që lam pas disa u zhvilluan "live" me mbështetjen e Projektit "Bashki të Forta", mbledhjet e tjera janë organizuar të hapura për publikun dhe disa të tjera në zoom. Dëgjesat publike përveçse të realizuara në terren, qytetarëve ju krijua mundësia që të jepnin mendime e tyre, komente, rekomandime online në email-et dhe kontaktet e Sekretres dhe përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak Kuçovë (të vendosura në faqen web të Këshillit). Në platëformat online nuk pati rekomandime nga qytetarët ndërsa në takimet e organizuara në terren dolën 12 rekomandime.

- Raporti gjendet i postuar në faqen e Këshillit Bashkiak Kuçovë në facebook dhe në Web www.bashkiakucove.gov.al (rubrika Llogaridhënie dhe performancë, nëndarja Raportet e KB).

SEKRETARI I KËSHILLIT

Alda HODO



KRYETARI I KËSHILLIT

Migena BULLARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

Nr. Prot 304

Datë 17.03.2022

**INFORMACION PËR RAPORTIN VJETOR TË VENDIMMARRJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK KUÇOVË PËR VITIN 2021**

Raporti vjetor i vendimmarrjes, bazuar në pikën 1, neni 16 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 20 në ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe neni 152 i rregullores së Këshillit Bashkiak Kuçovë, nr. 38, datë 22.04.2020, Këshilli Bashkiak është i detyruar të hartojë dhe të publikoj raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihen informacionet si më poshtë:

- Numri i Akteve të miratuara gjatë vitit;
- Numri e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- Numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- Numri i takimeve publike të organizuara;
- Forma e njoftimit publik;
- Datat e takimeve të hapura për Këshillin publik;
- Grupet e këshilluara në takimet e hapura.

Referuar sa më sipër Këshilli Bashkiak Kuçovë gjatë vitit 2021 ka kryer vendimmarrjen si më poshtë:

- Numri i Akteve të miratuara gjatë vitit 2021 ishin 86.
- Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara ishin 12.
- Numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra nga palët e interesuara ishin 8.
- Numri i takimeve publike të organizuara ishin 6.